

Miloševiću, XVII, 310; *Šta je sa očetima*, Ilustrovana politika, 28.11.1998, 7-8, FDH-32281; FDH, *Fati i serbëve...*, 2-4, FDH-14277.

Vitomir (Mladen) Kostić-Vitko

(28.05.1928, serb nga Retia/Retimlje, komuna e Rahovecit/Orahovac, pensionist, i pamartuar)

Dimitrije (Dušan) Kostić

(24.10.1932, serb nga Retia/Retimlje, komuna e Rahovecit/Orahovac, bujk, katër fëmijë)

Vekoslav (Dimitrije) Kostić

(20.10.1958, serb nga Retia/Retimlje, komuna e Rahovecit/Orahovac, punëtor në KIB Orvin)

Miroljub (Dimitrije) Kostić

(28.08.1967, serb nga Retia/Retimlje, komuna e Rahovecit/Orahovac, punëtor në KIB Orvin)

Andelko (Nikola) Kostić

(8.02.1936, serb nga Retia/Retimlje, komuna e Rahovecit/Orahovac, bujk, gjashtë fëmijë)

Živko (Andelko) Kostić

(15.05.1976, serb nga Retia/Retimlje, komuna e Rahovecit/Orahovac, punëtor në fabrikën 18 Nëntor)

Mladen (Nikola) Kostić

(22. 02.1940, serb nga Retia/Retimlje, komuna e Rahovecit/Orahovac, tre fëmijë)

Nebojša (Mladen) Kostić

(12.03.1980, serb nga Retia/Retimlje, komuna e Rahovecit/Orahovac, nxënës)

Miodrag (Stajko) Kostić

(19.09.1960, serb nga Retia/Retimlje, komuna e Rahovecit/Orahovac, punëtor në KIB Orvin, dy fëmijë)

Svetislav (Stajko) Kostić

(2.06.1965, serb nga Retia/Retimlje, komuna e Rahovecit/Orahovac, i papunë)

Srećko (Stanoje) Kostić

(29.01.1974, serb nga Retia/Retimlje, komuna e Rahovecit/Orahovac, kimist)

Saško (Dragoljub) Kostić

(14.01.1976, serb nga Retia/Retimlje, komuna e Rahovecit/Orahovac, punëtor)

Todor (Božidar) Kostić

(30.07.1965, serb nga Retia/Retimlje, komuna e Rahovecit/Orahovac, punëtor në plantacionet e KIB Orvin)

Lazar (Božidar) Kostić

(8.03.1972, serb nga Retia/Retimlje, komuna e Rahovecit/Orahovac, referent, një fëmijë)

Rajko (Ilija) Nikolić

(14.06.1955, serb nga Retia/Retimlje, komuna e Rahovecit/Orahovac, bujk, katër fëmijë)

Cvetko (Rajko) Nikolić

(18.04.1981, serb nga Retia/Retimlje, komuna e Rahovecit/Orahovac, nxënës)

Familjet Kostić dhe Nikolić ishin familjet e vetme serbe në **Reti/Retimlje**. Të gjithë i kishin shtëpitë në periferi të fshatit, përpos Vitomirit dhe bashkëshortes së tij Živodarka, që jetonin në qendër të Retisë/Retimlje. Në fund të muajit maj të vitit 1998, serbët filluan të mbanin rojë sepse dëgjuan se shqiptarët kishin filluar të armatoseshin. Në fillim të muajit korrik të vitit 1998, shqiptarët nga fshati Samadraxhë/Samodraža kanë shtënë mbi Rajkon, të birin Mitrin dhe të bijën Kristinen. Kur, më 10.07.1998, u rrëmbye Jugoslav Kostić [të shikohet regjistrimi], disa banorë i nxorën dhe i strehuan fëmijët jashtë fshatit.

Në datën 17.07.1998, një shqiptar e ka ndalur Rajkon përpara shtëpisë së tij, por ky arriti që të ikte me vrap. Pas kësaj, burrat serb i rrokën armët dhe i zunë pozicionet e rojës. Në të njëjtën mbrëmje [18.07.1998], pjesëtarë të UÇK-së kanë nisur të gjuanin me armë zjarri nga drejtimi i fshatit Opterushë/Opteruša mbi shtëpitë e familjeve Nikolić dhe Kostić. Që të gjithë 17 burrat serb u kundërpërgjigjeshin, duke shtënë nga armët e veta. Gjatë shkëmbimit të zjarrit u plagosën Todori dhe Živko. Nga ora 4:00 të mëngjesit, i ati i Živkos, Andelko, doli në oborr për të parë çfarë ndodhi me të birin. Në atë çast plumbi e qëlloi në kokë, duke e lënë të vdekur në vend. Rreth orës 10:00, pjesëtarë të UÇK-së e dërguan Sreten Simićin nga Opterusha/Opteruša me letrën në të cilën familjeve Kostić dhe Nikolić u premtuhej se do të liroheshin nëse i dorëzonin armët. Në të kundërtën do të “digjeshin” u tha në letër. Serbët e pranuan ultimatumin. Burrat shkuan në qendër të fshatit dhe u dorëzuan. Ushtarët i çarmatosën serbët dhe i rreshtuan pranë shtëpisë së Ismet Berishes, në anën e